



Bashkë-financuar
nga Bashkimi Evropian

Bashkë-financuar nga Agjencia
Ndërkombëtare Suedeze për
Zhvillim dhe Bashkëpunim



Sweden
Sverige

RAPORT MONITORUES

MJEDISI DHE GJINIA

BASHKIA PUKË

Nëntor 2022



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



Bashkë-financuar
nga Bashkimi Evropian

Bashkë-financuar nga Agjensia
Ndërkombëtare Suedeze për
Zhvillim dhe Bashkëpunim



Sweden
Sverige

Ky Raport monitorues është hartuar në kuadrin e projektit "***Krijimi i Aleancave Lokale Feministe Mjedisore***", që implementohet nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe mbështetjet nga Reactor - Research in Action dhe partnerët e tyre përmes Aksionit "***Përparimi i Barazisë Gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE***". Ky Aksion financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe është bashkëfinancuar nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian apo të Agjensisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Përgatitur nga:

Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE.....	4
BASHKIA PUKË	4
PROFILI I BASHKISË	5
KUADRI LIGJOR	8
STRATEGJIA MJEDISORE	10
ANALIZË E OBJEKTIVAVE DHE PËRMBUSHJA E TYRE NGA BASHKITË.....	10
PLANET E BASHKISË	13
GJETJET NGA TAKIMET ME KOMUNITETIN	16
KONKLUZIONE	17

Hyrje

Gjatë vitit 2022 Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" zhvilloi projektin Krijimi i Aleancave Feministe Lokale dhe Mjedisore. Projekti mbështetet nga "Reactor Research in Action" dhe partnerët e tyre përmes Aksionit "Përparimi i Barazisë Gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE". Ky Aksion financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Agjensia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Projekti kishte për qëllim mbështetjen e organizatave locale të grave në avancimin e kapaciteteve të tyre në gjini dhe mjedis duke përdorur një qasje të "të mësuarit duke bërë" dhe të adresojë në mënyrë efikase çështjet mjedisore nga një perspektivë gjinore.

Për këtë arsye në bashkëpunim me grupet qytetare dhe organizatat lokale, u përqendruam në Kamëz, Pukë dhe Vlorë. Gjatë ciklit të projektit, më shumë se 400 gra dhe vajza u bënë pjesë e takimeve të roganizuara për advokacinë mjedisore; më shumë se 60 të rinj u trajnuan mbi gjininë dhe mjedisin dhe rreth 50 zyrtarë të pushtetit vendor u bënë pjesë e takimeve tona. Tre Aleanca Mjedisore Feministe Lokale u ngritën, duke u bërë kështu zëri i grave dhe vajzave në të tre bashkitë për advokimin e çështjeve mjedisore dhe lidhjen e tyre me mjedisin.

Në vijim, organizatat partnere monitoruan bashkitë respektive dhe dolën me këtë raport monitorues sa i përket situatës aktuale në Pukë, Vlorë dhe Kamëz me qëllim përmirësimin e treguesve mjedisorë në secilën prej bashkive, veçanërisht në fushën e menaxhimit të mbetjeve, ndotjes dhe riciklimit.

Bashkia Pukë

Bashkia e Pukës është një ndër zonat e pasura minerare të vendit, e cila disponon gjithashtu një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore. Megjithatë, prerja pa kriter e pyjeve ka shkaktuar jo pak probleme për këtë zonë. Mbyllja e minierave apo dhënia e tyre me koncesion ka shtuar numrin e të papunëve në Pukë, duke e kthyer varfërinë në një problem akut për banorët e zonës. Për shkak të saj, një pjesë e mirë e popullatës ka migruar në drejtim të Shqipërisë së Mesme ose emigruar jashtë Shqipërisë. Remitancat janë një burim i rëndësishëm mbijetese për këtë bashki. Prej vitesh në këtë zonë kanë munguar investimet me rëndësi, ndërsa rruga Durrës-Kukës e ka aneksuar dhe izoluar edhe më shumë Bashkinë e Pukës.

Terreni malor i Pukës është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit malor; krahas pasurive dhe burimeve natyrore me vlera të mëdha ekonomike që gjenden brenda hapësirës gjeografike të Pukës, kryesisht pyje natyrore, bimë mjekësore, pasuri nëntokësore minerare. Problem për Bashkinë e Pukës vijon të mbetet stina e dimrit, ku bllokimi i rrugëve nga dëbora izolon një pjesë të mirë të zonës dhe vështirëson edhe më shumë jetesën e banorëve.

Sfidat me të cilat përballet pushteti vendor pas ndarjes së re

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore konsiderohet një ndër sfidat kryesore për Bashkinë e re të Pukës. Rrugët dytësore që lidhin fshatrat e Gjegjanit, Qelëz dhe Luf-Qerretit me qytetin e Pukës dhe dërgimi i shërbimit shëndetësor në këto fshatra, ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së banorëve.

Përpunimi i drurit shihet si një aktivitet me rëndësi për gjallërimin ekonomik të zonës, por ky aktivitet *duhet shoqëruar me kritere të rrepta në shfrytëzimin e fondeve pyjore*. Paralelisht me këtë aktivitet, *mbështetja e bujqësisë dhe e blegtorisë* konsiderohet e domosdoshme për zonën e Pukës. Mbështetja e biznesit fason për hapjen e fabrikave në këtë bashki mendohet si një mundësi e mirë për punësimin e grave dhe vajzave, si edhe për gjenerimin e të ardhurave. Nxitja e aktiviteteve të vogla ekonomike në Bashkinë e Pukës do të ishte më e dobishme, nëse fokusohej në traditat ekzistuese artizanale dhe prodhimin e bimëve mjekësore apo produktet e drurit.

Disa nga prioritetet e investimeve në Pukë janë: *furnizimi me ujë, ndricimi rrugor, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave dhe caktimi i një vend depozitimi, mirëmbajtja e kopshteve dhe shkollave, ngrohja e tyre dhe pasurimi me aktivitete kulturore dhe sportive*. Aktualisht, cilësia e shërbimeve dhe infrastrukturës është mesatare dhe infrastruktura lokale, që lidh fshatrat me njesitë administrative duhet përmiresuar, edhe pse numri i banorëve është i ulur ndjeshëm.

Bazuar në Raportin e Performancës së bashkisë Pukë për vitin 2021, në seksionin e shërbimeve publike citohen 3 objektiva specifike: 1. Garantimi për të gjithë qytetarët e saj shërbime publike cilësore në të gjithë territorin e saj pavarësisht vendndodhjes së tyre. 2. Shërbim cilësor me standarte dhe sipas normativave të rregullores së Mirëmbajtjes së Varrezave. 3. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike.

Gjatë vitit 2022, janë marrë disa nisma në përmirësimin e shërbimeve në varrezat e dëshmorëve dhe në ato të qytetit dhe të fshatrave.

Profili i Bashkisë

¹Zona Gjeografike: Puka kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë e Vaut të Dejes, në lindje me Bashkinë Fushë Arrëz dhe në jug me Bashkitë Mirditë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Pukës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia e Pukës ka 11,069 banorë. Ajo ka një sipërfaqe prej 505.53 km² me një densitet prej 33.30 banorë/km² sipas Regjistrisë Civile dhe 21.89 banorë/km², sipas Censurit 2011.

Vetëm 72% e popullsisë së rregjistruar në gjendjen civile jeton fizikisht në territorin e kësaj Bashkie, pjesa tjetër janë larguar në drejtim të zonave të tjera të Shqipërisë apo në emigracion. Arsyet kryesore të kësaj lëvizje të popullsisë jashtë Bashkisë Pukë janë ekonomike. Edhe pse kjo Bashki është ndër zonat e pasura me minerale, mbyllja e

¹ Burimi i informacionit: *Birn Reporter.al*

minierave është shoqëruar me rritjen e papunësisë dhe pamundësinë për të siguruar punë në këtë territor.

Në këndvështrimin e analizës së situatës së grupeve vulnerabël dhe nevojave të tyre për shërbime, treguesit demografikë janë të rëndësishëm për të vlerësuar madhësinë e grupeve në nevojë për shërbime në raport me popullsinë e Bashkisë, si dhe për të vlerësuar burimet njerëzore që duhet të ketë Bashkia në dy nivelet e organizimit (Bashki dhe njësi administrative) si detyrim, që rrjedh nga legjislacioni kombëtar.

Njësia Administrative	Numri Popullsisë	Numri Familjeve	Popullsia sipas grup moshave				
			0-6 vjeç	7-15 vjeç	16-18 vjeç	19-64 vjeç	65+ vjeç
Pukë dhe Rrapë	8743	3120	597	901	431	5913	901
Gjegjan	3728	1290	315	453	167	2396	397
Qerret dhe Qelëz	2846	991	215	372	141	1811	307
TOTALI	15 317	5 401	1 127	1 726	739	10 120	1 605

Tabela 1: Të dhëna të popullsisë në Bashkinë Pukë²

Siç shihet në tabelën 1, janë 5,401 familje të rregjistruara në këtë Bashki. Numri mesatar i pjesëtarëve në familje është 2.8.

Të dhëna të tjera: Bashkia e Pukës është një ndër zonat e pasura minerare të vendit, e cila disponon gjithashtu një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore. Megjithatë, prerja pa kriter e pyjeve ka shkaktuar jo pak probleme për këtë zonë.

Mbyllja e minierave apo dhënia e tyre me koncesion ka shtuar numrin e të papunëve në Pukë, duke e kthyer varfërinë në një problem akut për banorët e zonës. Për shkak të saj, një pjesë e mirë e popullatës ka migruar në drejtim të Shqipërisë së Mesme ose emigruar jashtë Shqipërisë. Të ardhurat nga emigracioni janë një burim i rëndësishëm mbijetese për këtë bashki. Prej vitesh në këtë zonë kanë munguar investimet me rëndësi, ndërsa rruga Durrës-Kukës e ka aneksuar dhe izoluar edhe më shumë Bashkinë e Pukës.

Terreni malor i Pukës është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit malor; krahas pasurive dhe burimeve natyrore me vlera të mëdha ekonomike që gjenden brenda hapësirës gjeografike të Pukës, kryesisht pyje natyrore, bimë mjekësore, pasuri nëntokësore minerare. Gjatë viteve të fundit, një numër i vogël turistësh janë rikthyer në Pukë për shkak të hapjes së një piste skish dhe ndërtimit të disa haneve turistike. Megjithatë, numri i tyre vazhdon të mbetet i ulët.

Bashkia Pukë³ është ndodhet në pjesën veriore të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe prej 1,033.39 km² dhe një popullsi prej 11.069 banorë (Census 2011). Nga pikëpamja

² Burimi: <https://bashkiapuke.gov.al/%C3%ABp-content/uploads/2021/07/PLANI-SOCIAL-BASHKIA-PUKE-FINAL.docx> (shtojca 5)

administrative, Qarku Shkodër (në veri të Shqipërisë) i cili përfshin Bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau-Dejës dhe FushëArrëz, kufizohet me Malin e Zi dhe Kosovën. Qendra e Bashkisë Pukë është qyteti me të njëjtin emër. Bashkia Pukë kufizohet në veri - veriperëndim me Bashkinë e Vaut të Dejës; në lindje - verilindje me Bashkinë Fushë-Arrëz, të cilat ndodhen brenda Qarkut Shkodër, dhe në jug me Bashkitë Mirditë dhe Lezhë, të Qarkut Lezhë, duke pasur si kufij natyral kreshtat malore Maja e Runës, Thirrës, Maja e Roshit dhe Bjeshkët e Tërbunit. Kufinj të Bashkisë Pukë u ri-përcaktuan në kuadër të projektit të fundit të qeverisjes qendrore, në përputhje me Ligjin Nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, i cili ripërcaktoi kufijtë e njësive vendore dhe rajonale.

Si rrjedhojë, me konfigurimin e ri, Bashkia përbëhet 5 prej njësish administrative:

1. Ish Bashkinë Pukë, e cila përfshin qytetin dhe fshatin me të njëjtin emër dhe fshatin Lajthizë.
2. Ish Komunën Gjegjan, që përfshin fshatrat: Dom, Gjegjan, Gojan i Vogël, Rras, Kuzhnën, Gojan i Madh, Shkozë, Kimëz, Kalivare dhe Mesul.
3. Ish Komunën Rrapë, që përfshin fshatrat: Breg, Rrapë, Kabash, Buhot, Bicaj, Bilnisht, Lumzi dhe Meçe.
4. Ish Komunën Qelëz, që përfshin fshatrat: Qelëz, Bushat, Dushnezë, Midhë, Buzhalë, Dedaj, Levrushk, Ukth dhe Qerret i Vogël.
5. Ish Komunën Qerret, që përfshin fshatrat: Qerret, Luf, Dush, Karmë, Kcirë, Luf-Plan, Korthpulë, Kaftall, Tejkodër, Gomsiqe, Vrith dhe Plet.

Në bazë të propozimit të Bashkisë për kufirin administrativ, fshati Koman përfshihet në zonën e studimit për Planin e Përgjithshëm Vendor, i cili sipas Ligjit Nr.115/2014 i përket Bashkisë Vau i Dejës. Terreni është malor (me një lartësi mesatare mbi nivelin e detit prej 787m mbi nivelin e detit) dhe i larmishëm, me maja të larta, shpate të mprehta, lugina, kanione, shpella dhe rrjet të pasur hidrografik me lumenj, përrenj, burime dhe ujëvara. Sipërfaqet e gjera të tokës janë të mbuluara me pyje dhe livadhe. Nga veriu rrjedh lumi Drin dhe formohen liqenet Koman-Fierzë. Bashkia ka një histori të gjatë dhe gjurmë të ruajtura e të shpërndara në pjesë të ndryshme të territorit të saj. Legjendat, traditat dhe zakonet mbijetojnë dhe janë ringjallur nëpër ngjarje të ndryshme kulturore.

Banorët janë të punësuar në bujqësi, blegtori dhe në qytet në biznese të vogla dhe të mesme. Gjithashtu, vlen të përmendet se janë zhvilluar aktivitete industriale dhe minerare për shkak të depozitave të pasura dhe rezervave me lëndë të para, veçanërisht minerale, por në vitet e fundit këto aktivitete janë ndërprerë.

³ https://bashkiapuke.gov.al/www-content/uploads/2017/09/ANALIZA_DHE_VLER%C3%8BSIMI_I_TERRITORIT.pdf

Infrastruktura kryesore rrugore, e cila ofron qasje bazë në bashki, është rruga SH5 që i përket rrjetit primar rrugor kombëtar, i cili e lidh së pari me Kukësin dhe Morinën portën kryesore për në Kosovë dhe së dyti me Shkodrën, qendër kryesore urbane dhe nyje Kombëtare multimodale, bregun perëndimor të vendit dhe Hanin e Hotit si portë për Malin e Zi.

Disa nga avantazhet krahasuese të Bashkisë janë: trashëgimia kulturore (e prekshme dhe e paprekshme), peizazhi veçanërisht i bukur, mjedis i qetë dhe i pastër, flora dhe fauna e shquar, burimet e pasura natyrore (rezervat minerale, pyje, ujra), dhe produktet bujqësore dhe blegtorale (duke përfshirë bimët medicinale dhe manaferrat) dhe kualifikimi i banorëve në grumbullimin dhe përpunimin e tyre. Këto të dhëna ofrohen për diversifikimin / forcimin e ekonomisë lokale dhe zhvillimin e aktiviteteve të reja, të tilla si: turizmi alternativ dhe malor.

Në Pukë, klima është e ngrohtë dhe e butë. Ka reshje të mjaftueshme gjatë gjithë vitit. Edhe në muajin më të thatë të vitit ka akoma shumë reshje shiu. Reshjet mesatare vjetore janë 1270 mm. Muaji më i thatë është korriku, ku reshjet janë 54 mm. Pjesa më e madhe e reshjeve bie në nëntor, me një mesatare prej 161 mm. Reshjet ndryshojnë 107 mm midis muajit më të thatë dhe muajit më të lagesht. Temperatura mesatare vjetore është 10.2°C në Pukë. Muaji më i ngrohtë është korriku me një mesatare prej 19.5°C. Në Janar, temperatura mesatare është 0.5°C. Kjo është temperatura mesatare më e ulët e tërë vitit

Kuadri Ligjor⁴

Kuadri Ligjor për vetqeverisjen vendore, i targeton bashkive përgjegjësi edhe në ceshtjet mjedisore:

Në varësi të kuadrit ligjor nr 139/2015⁵, për **ligji i Vetëqeverisjes vendore**, nenet që mbulojnë përgjegjësinë juridike të institucioneve mbi mbrojtjen e mjedisit.

Neni 23: Bashkia ushtron funksionin publik për të garantuar infrastrukturën e duhur të shërbimeve publike në: prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm; menaxhimin e plotë të ujërave të ndotura, dhe të ujërave të shiut duke siguruar mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara.

Neni 26: I targeton Bashkive përgjegjësinë mbi sigurimin e masave mbrojtëse për cilësinë e ajrit, tokës, dhe ujit nga ndotja, por gjithashtu dhe marrjen e masave mbrojtëse nga ndotja akustike. Më tej, bashkitë kanë detyrim të zhvillimit të aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, rreth çështjeve të mbrojtjes së mjedisit.

Neni 27: Bashkitë kanë përgjegjësi në administrimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujit dhe kullimit, të zotëruar në pronësi të tyre sipas ligjit. Bashkitë ndërmarrin administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore dhe burimeve të kategorive të tjera. Bashkia garanton krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe

⁴ Kuadri ligjor i përmbledhur (që vesh me përgjegjësi bashkitë)

⁵ https://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf

të këshillimit bujqësor e rural. Bashkia ndërmerr nismën e krijimit dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas ligjit. Bashkia krijon dhe administron skemat vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, duke garantuar akses të balancuar gjinor.

Nga ana tjetër gjendet edhe një kuadër ligjor kombëtar mbi mjedisin, i përmbledhur si më poshtë:

- Ligji Nr.10 431⁶, datë 9.6.2011 “PËR MBROJTJEN E MJEDISIT” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij
- Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”. VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, kushtet e lejeve respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.
- Ligji nr.8906, datë 06.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- Ligji nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, ndryshuar me Ligjin nr. 69/2014.
- Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”. 5.1 VKM nr. 866, datë 10.12.2014 “Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për komunitetin evropian”.

LIGJ Nr 10 431 datë 9.6.2011 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

- *KA SHFUQIZUAR: Ligjin nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për Mbrojtjen e mjedisit” (i përditesuar), i ndryshuar*
- LIGJ Nr. 10 448, datë 14.7.2011 PËR LEJET E MJEDISIT
- I ndryshuar me: ligjin nr.44/2013
- ligjin 60/2014, i përditësuar
- LIGJI Për burimet e rinovueshme 138/2013 (I përditësuar)
- I Ndryshuar me:ligjin nr. 26, datë 20.3.2014
- Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për Transportet rrugore” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 8908, datë 06.06.2002
- Ligjin Nr. 9096, datë 03.07.2003
- Ligjin Nr. 9373, datë 14.04.2005
- Ligjin Nr. 9760, datë 21.06.2007
- Ligjin Nr. 10 137, datë 11.5.2009
- Ligjin Nr. 10 302, datë 15.7.2010
- Ligjin nr. 21/2013, date 14.2.2013 FZ 29
- Ligjin nr.37/2014, date 10.4.2014 FZ 63

⁶ <https://portavendore.al/cbenbashkia/mbrojtja-e-mjedisit/>

- Ligji nr. 9734, datë 14.5.2007 “Për Turizmin” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 9930, datë 09.06.2008
- Ligjin 76/2013 datë 14.2.2013 fz 31
- Ka Shfuqizuar: Ligji nr. 7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar
- Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për Zonat e mbrojtura” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 9868, datë 04.02.2008
- Ligji nr. 9362, datë 24.3.2005 “Për Shërbimin e mbrojtjes së bimëve” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 9908, datë 24.04.2008
- Ka Shfuqizuar: Ligjin nr. 7662, datë 19.1.1993 “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve
- Ligji nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për Mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 10 137, datë 11.5.2009
- Ka Shfuqizuar: Ligjin nr.7707, datë 17.5.1993 “Për mbrojtjen nga zjarri”
- Ligji nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për Administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”. (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 10 137, datë 11.5.2009
- Ligji nr. 10 463, date 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (Ipërditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligji nr. 32/2013 datë 14.2.2013 FZ 30
- Ligji nr. 156/2013, date 30.5.2013, FZ 172
- Ka Shfuqizuar:
- ligjin nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin e mbetjeve të ngurta”
- ligjin nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”

Strategjia mjedisore

Analizë e objektivave dhe përmbushja e tyre nga bashkitë

Zona e Pukës, pavarësisht dëmtimeve që mund të ketë hasur ndër vite, (prerje e pyjeve pa kriter, derdhje mbeturinash në lumenj e përrenj etj), në përgjithësi mbetet një zonë e pastër dhe e padëmtuar. Qyteti Pukë ka sipërfaqe të gjelbërta në një nivel të kënaqshëm (rreth 5,400 m²) në funksion të numrit të popullsisë dhe hapësirës së lirë urbane.

Problemet kryesore mjedisore në bashkinë Pukë, lidhen kryesisht me dëmtimin dhe ndotjen e burimeve natyrore si: shfrytëzimi pa kriter i pyjeve, ndotjen e ujrave, apo depozitimi i mbetjeve urbane në zona të hapura.

Dikur, Bashkia e Pukës i depozitonte mbetjet urbane në një fushë të hapur në vendin e quajtur Fusha e Qarrit. Kjo fushë, e cila administrohej nga Bashkia e Pukës, megjithëse disponon lejet përkatëse nga Ministria e Mjedisit (prej vitit 2002), siguronte kushtet minimale teknike, higjieno-sanitare apo mjedisore për trajtimin e mbetjeve. Në këtë fushë, mbetjet depozitoheshin në mënyrë të çrregullt dhe digjeshin, duke krijuar një problem serioz për zonat përreth.

Tashmë është eliminuar dhe pastruar zona e ish vend-depozitimit të mbetjeve, me një fond nga Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe bashkia do e shndërrojë në aneks stadium, që do të shërbejë për stërvitjen e skuadrave sportive.

Për sa i përket ndotjes mjedisore, janë hasur fenomene të tilla, si: ndotja e liqeneve të zonës së Pukës (Fierzës, Komanit, etj. – ku ka pasur shqetësime ndotjesh sepse vizitorët, udhëtarët drejt pikave turistike të zonës hedhin mbetje, sikurse edhe banorët e fshatrave rrotull i hedhin mbetjet në lumenjtë dhe përrrenjtë rrotull).

Shpyllëzimi pa kriter i pyjeve të Pukës ka qenë një tjetër problematikë me një sërë pasojash që i sjellin biodiversitetit, erozonit të tokave, zhdukjes së gjallesave, etj. Psh: ka pasur zona pyjore më të çënuara nga shpyllëzimi apo nga zjarret?

Vatra zjarri kanë rënë herë pas here gjatë stinës së nxehtë dhe bashkia me institucionet e mbrojtjes së pyjeve kanë ndihmuar në mbajtjen nën kontroll dhe shuarjen e tyre. Mesatarisht, ka pasur 3 vatra zjarri për ccdo sezon vere.

Në zonat pyjore ka specie kafshësh drejt zhdukjes. Mali i Munellës është zonë e mbrojtur për shkak të rrëqebullit, i vetmi habitat ku jeton në Ballkan kjo kafshë. Zhdukja e tij ndikon në prishjen e ekuilibrave të florës dhe faunës.

Sa i takon shpyllëzimeve pa kriter, qëkurse është miratuar memorandum i pyjeve nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, nuk ka më dëmtime masive. Ka hapa të ngadaltë të rigjenerimit të pyjeve të shkatërruara.

Sa i takon ngrohjes së ambienteve të brendshme gjatë dimrit në Pukë bëhet me dru zjarri dhe rrallëherë me alternativa të tjera. Drutë blihen nga biznese të licensuara. Edhe bashkia Pukë bën grumbullimin dhe shitjen e druve të zjarrit për banorët, nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve. Ka familje që ngrohjen e sigurojnë nëpërmjet kondicionerëve, kaldajave, ose ngrohje me gaz, por ky sistem ngrohje ka pak përdorim sepse kushton shumë. Nga ana tjetër, disiplinimi dhe ndërgjegjësimi i banorëve për përdorimin e burimeve alternative për ngrohje është i ulët. Ka filluar nga disa familje sistemi i veshjes së jashtme kapot për banesat, por rastet janë në familjet me mundësi ekonomike të larta.

Ka familje të nivelit ekonomik të ulët, që ende presin pa kriter dru në pyll dhe i përdorin për ngrohje. Nga përdorimi i drurit për ngrohje krijohet ndotje në atmosferë. Nuk ka ndonjë qëndrim nga institucionet përkatëse ndaj fenomenit meqenëse alternativat e tjera janë të kushtueshme.

Bashkia Pukë konsiderohet si qendër urbane terciare. Sa i takon zhvillimeve të pritshme në të ardhmen, lidhur me qendrat e nivelit të tretë, ku përfshihen Mat, Klos, Pukë, Rrëshen dhe Vau i Dejës, zgjedhje strategjike është nga njëra anë forcimi i lidhjes së tyre me portat – qendra të hyrjes së vendit, portet dhe aeroportet dhe nyjet multimodale të transportit kombëtar dhe nga ana tjetër përmirësimi i aksesit të qendrave lokale nga qendra e Bashkisë. Paralelisht, janë të nevojshme ndërhyrjet rehabilituese në qendrat e nivelit të tretë, të cilat disponojnë ndërtesa me vlerë dhe revitalizim të industrive me përdorime të reja ekonomike në fushën e industrisë, të përpunimit dhe industrisë së ushqimit (p.sh. prodhimi i produkteve standarde dhe të njohura të tilla si mjalti, vera, rakia).

Gjithashtu, rivitalizimi rekomandohet në lidhje edhe me konsolidimin e elementëve historikë, arkitektonikë dhe kulturorë me qëllim për t'i shërbyer ekonomisë së turizmit. Veçanërisht e rëndësishme për këto qendra është nxitja e bashkëpunimit mes tyre, si edhe bashkëpunimi me qendrat urbane të afërta të nivelit të parë. Ka përfitime nga afërsia e Bashkisë Pukë me dy zona ndërkufitare të bashkëpunimit, e cila promovohet më tej në kuadër të programeve IPACB: (a) Kukës-Prishtinë ku përfshihet aeroporti i Kukësit dhe (b) Shkodër-Podgoricë, ku përfshihet porti i Shengjinit.

Administrimi i shërbimit të mbetjeve është një tjetër problematikë për zgjidhje.

Që prej vitit 1994 grumbullimi dhe trajtimi i mbetjeve dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve lokale, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre dhe njëkohësisht, duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të “granteve të pakushtëzuara”. Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Qeverisje vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga Ligji i ri nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ku në nenin 12, pika 2 citohet:

“Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji”.

Planifikimi krahas edukimit dhe aspekteve financiare si edhe legislative është përcaktuar si një nga katër shtyllat kryesore vendimtare për zbatimin e politikës dhe strategjisë së menaxhimit të mbetjeve. Një Plan Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane, konsiston në përpilimin e një dokumenti strategjik, i cili do të mundësojë zbatimin e direktivave dhe politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor.

Prodhimi i mbetjeve në nivel vendor:

Të dhënat zyrtare nga Bashkia Pukë në lidhje me prodhimin e mbetjeve janë ende të debatueshme dhe bazohen vetëm në vlerësime të përgjithshme duke u bazuar në numrin e popullsisë të qytetit, (i cili gjithashtu është i ndryshëm nëse bazohet në dy burime INSTAT apo Ministria e Financave dhe Ekonomisë), kapacitetet e kontenierëve që makina teknologjike mbledh gjatë ditës dhe sasisë së mbetjeve të riciklueshme. Makina që transporton mbetjet për në vend depozitim nuk peshohet dhe nuk është bërë asnjë përpjekje për të numëruar ngarkesat e makinave dhe për të llogaritur vëllimin e mbetjeve në vend depozitim.

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve konsiston në mbledhjen e mbetjeve urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet brenda kontenierëve publikë, si dhe rreth tyre, dezinfektimi i kontenierëve dhe vendit përreth me gëlqere dhe klor, transportimi i mbetjeve urbane me makinën teknologjike deri në pikën përfundimtare të depozitimit. Ky shërbim që ofrohet gjatë gjithë vitit përfshin pjesën më të madhe të zonës urbane (rreth 90%), kryesisht në akset kryesorë të rrugëve, ku janë të pozicionuar pjesa më e madhe e kontenierëve.

Sistemi aktual i pikave të grumbullimit mbetjeve (PGM) përbëhet nga kontenierë metalik me rrota me volum 1.1m^3 , të pozicionuar në anë të rrugëve në pika të përbashkëta publike të miratuara paraprakisht nga autoritet bashkiake. Largësitë mesatare midis PGM variojnë nga çdo 100ml në zonën e qendrës ku është e përqëndruar pjesa më e madhe e bizneseve, institucioneve dhe banorëve si dhe zonat e tjera të qytetit të Pukës, në 200-400ml. Në këto pika informale, të paautorizuara, grumbullohen si mbetjet urbane ashtu dhe inerte dhe voluminoze, duke u kthyer në problematikë të ndotjes urbane, si nga ana vizive ashtu dhe në lidhje me shëndetin publik dhe mjedisin përreth. Njëkohësisht, ekzistojnë pak pika individuale, ku kontenierët janë të pozicionuar brenda territoreve të institucioneve apo subjekteve private.

Bashkia kontrollon makinat e transportit që ka vetë në operim dhe deklaron se nuk kemi shkarkime informale apo nga palë të tjera në fushë.

Bashkia e Pukës duhet të përgatisë dhe miratojë rregulloren lokale për administrimin e shërbimit të mbetjeve, ku të përcaktohet qartë roli dhe përgjegjësia e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve, me qëllim administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të saj administrativ. Kjo rregullore duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Planet e bashkisë

Paraqitje e planeve të bashkisë - buxheti 2022 që i është kushtuar mjedisit, si dhe integrimi gjinor

Detyrat dhe përgjegjësitë: Bazuar në ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011, bashkitë janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar.

Bashkia përcakton:


- i. Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban;

- ii. Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për menaxhimin e mbetjeve urbane në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t'i grumbullojnë ato;
- iii. Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë menaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret "tip" të miratuara nga MM, MTI dhe MSH;
- iv. Harton planet e manaxhimit të mbetjeve urbane në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje;
- v. Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit
- vi. Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve, si dhe kryen fushata sensibilizuese.

Në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe për mbetjet, bashkitë kanë detyrimet si më poshtë:

- (i) Të kujdesen për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura;
- (ii) Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve;
- (iii) Të monitorojnë dhe inspektojë të gjitha proceset e manaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në depozitimin përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualët lokale;
- (iv) Të inspektojnë "zotëruesin e mbetjeve" për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh;
- (v) Të bashkëpunojë me ARM për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e manaxhimit të mbetjeve;
- (vi) Të bashkëpunojë me ISHMP, ARM si dhe inspektoriate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal;
- (vii) Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

Akualisht, nuk ka të dhëna të detajuara të buxheti të vitit 2022 mbi menaxhimin e mbetjeve. Në tabelën më poshtë paraqitet buxheti për Bashkinë Pukë.



Shpenzimet 2 rows 6 fields

Abc	#	#	#	#	#
Shpenzimet	Shpenzimet	Shpenzimet	Shpenzimet	Shpenzimet	Shpenzimet
Programi	Fakt 2019 (Sheet11)	Plan 2020	Plan 2021 (Sheet11)	Plan 2022 (Sheet11)	Plan 2023 (Sheet11)
Menaxhimi i mbetjeve	347	947	1,000	1,000	1,000
Menaxhimi i mbetjeve	6,657	6,983	10,287	10,287	10,287

Zëri i buxhetit të llogaritur për pastrimin e mbetjeve në rang bashkie për vitin 2021-2022 llogaritet në 2.6% të buxhetit total të bashkisë Pukë (i referuar si shumatore e të dhënave nga të gjitha ish njësitë administrative tashmë pjesë integrale e Bashkisë Pukë). Çdo fillim viti, Bashkia e Pukës në zbatim të funksioneve ligjore dhe administrative, përcakton dhe miraton buxhetin vjetor ku përfshihet edhe shpenzimet e parashikuara për pastrimin.

Megjithatë, duke iu referuar të dhënave paraprake dhe intervistave me grupin e punës, rezulton se buxhetet e deritanishme për menaxhimin e mbetjeve, kanë qenë të pamjaftueshme për të mbuluar nevojat për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit, apo përmbushjen e investimeve e infrastrukturës së mbetjeve. Sidomos, kur pritet një centralizim i shërbimit apo investime në pajisje (makineri, kontenierë) apo infrastrukturë (stacion transferimi për mbetjet). Analiza e mëtejshme e skemës optimale dhe koston së plotë të kësaj skeme do të mundësojë një pamje më të qartë të nevojave dhe mundësisë së bashkisë për të realizuar qëllimet e veta.

Për rastin e Bashkisë Pukë,⁷ përveç kompostimit në nivel individual, një ndër metodat më të përshtatshme për kushtet dhe koston relativisht të ulët që ka, mund të jetë

kompostimi në mjedis të hapur. Kjo lloj metode nuk ka një kosto të lartë për investimin fillestar dhe mund të japë rezultate mjaft të favorshme, jo vetëm për uljen e sasisë së mbetjeve që shkojnë për trajtimin final, por edhe në prodhimin e nje sasi të konsiderueshme komposti, si: pleh organik, që mund të përdoret nga bashkia për qëllime publike. Bashkia mund të inkurajojë procesin e kompostimit, duke ofruar mbështetje financiare (grante, skema bashkëfinancimi); duke miratuar politika fiskale të favorshme për kompostimin e mbetjeve; duke kategorizuar sistemin aktual të tarifave dhe duke vendosur sanksione të veçanta në rast të mos zbatimit të tyre. Në kushte aktuale, kur Bashkia Pukë ka një territor shumë të madh nën administrim, mund të fillojë të testojë procesin e kompostimit të mbetjeve organike, duke e prezantuar si një projekt pilot në një nga lagjet e bashkisë që ka më shumë potencial dhe ka interes.

Metoda të tjera të kompostimit, që praktikohen në vendet e tjera të zhvilluara, dhe mund të shihen si të përshtatshme, janë:

- Kompostimi i mbetjeve në mjedis të hapur, kompostimi në nivel komuniteti
- Kompostimi me çlirim pasiv gazi
- Kompostimi me sistem kapës të gazit
- Kompostimi i mbyllur
- Kompostimi në konteinerë.

Bashkia do të përmirësojë shërbimet e ofruara për komunitetin me anë të një fondi investimesh, i cili do të financojë shërbime të tilla, si: infrastruktura rrugore, shërbime publike vendore, strehimi social, arsimit, infrastruktura e ujitjes dhe kullimit, pyjet dhe kullotat, menaxhimin e mbetjeve etj. Investimet vijnë me rënie në 2022 dhe zënë rreth 16% të buxhetit të përgjithshëm të bashkisë.

Gjetjet nga takimet me komunitetin

Gjatë diskutimeve vërehet mungesë e informacionit pasi me fjalën probleme të mjedisit konsiderohet vetëm hedhja apo prezenca e mbeturinave në hapësira të ndryshme publike dhe ndërgjigjësimi komunitar, sa i takon rritjes së edukimit rreth kujdesit për mjedisin, por mungon informacioni në lidhje me energjinë e rinovueshme, shtimin dhe rikuperimin e situatës në pyje, përdorimi i mjeteve motorrike dhe ndotja industriale dhe minerale të cilat në disa raste kanë paraqitur probleme në komunitetin e Pukës dhe Fushë – Arrëzit, veçanërisht uji që del nga miniera e kromit dhe nga fabrika, të cilat ndosin lumin dhe e bëjnë të pasigurtë përdorimin e produkteve bujqësore e blegtorale sa i takon konsumit të sigurtë.

Nevojitet shtimi i koshave të mbetjeve dhe përmirësimi i tyre në disa raste, pasi nga amortizimi rrjedhin, duke ndotur ambientet përrreth tyre veçanërisht në verë, ku konsumi është më i lartë dhe temperaturat ndikojnë në aromat e pakëndshme që krijohen. Po ashtu, të klorinohen koshat dhe sipërfaqet rrotull ku janë vendosur koshat.

Një problem tjetër është mosfunksionimi i rrjeteve të KUZ-së, i cili po ashtu veçanërisht në verë kthehet në burime infeksionesh për shkak të ndotjes që krijohet. Kjo problematikë po adresohet nëpërmjet një fushate nga GADC.

Fushatat advokuese qe po realizohen

Aktualisht, në Bashkinë Pukë ka vetëm një fushatë advokuese mjedisore që po zbatohet.

⁸Aleanca Feministe Mjedisore Pukë ka ndërmarrë nismën për të advokuar pranë Bashkisë Pukë për ndërtimin e kanalizimeve të largimit të ujrave të përdorura (KUZ) për disa banesa të lagjes së zonës së ish Frigoriferit. Aktualisht, këto ujëra funksionojnë me gropa septike ose derdhen në përrua duke krijuar ndotje të zonës rrotull dhe asaj që përshkohet nga ky përrua.

Konkluzione

Rekomandime - duke u bazuar ne gjetjet por edhe ne rekomandimet e fundit qe ka dhënë BE në progres raport.

Shqipëria dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) në Qershor 2006. MSA ka hyrë në fuqi në 1 Prill 2009. Në bazë të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, nenit 108 “Mjedisi” “Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Bashkëpunimi përqëndrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e komunitetit për fushën e mjedisit. Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, kryhet në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), në të cilin Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) kontribuon për kapitullin 27 të tij “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”.

Më 25 Mars 2020, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së miratoi hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë. Vendimi i Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së u miratua nga Këshilli Evropian më 26 Mars 2020. Këshilli mandatoi Komisionin Evropian për të vazhduar dhe përfunduar procesin e shqyrtimit analitik të acquis së BE-së, duke u nisur nga grupimi i thelbësoreve. Gjatë viteve 2018 dhe 2019, Komisioni Evropian zhvilloi të gjitha takimet shpjeguese të acquis komunitare për të 33 kapitujt.

Takimi shpjgues për kapitullin 27 (“Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”), u zhvillua më 13 -17 Maj 2019, në Bruksel. Në kuadër të përgatitjes për hapjen e negociatave për anëtarësim, qeveria shqiptare po vijon krijimin e strukturës negociuese për negociatat, përfshirë grupet ndërinstucionale të Punës për Integrimin Evropian. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, me Nr. 94, datë 20.5.2019, për “Ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstucionale të Punës për Integrimin Evropian”, për kapitullin 27 “Mjedisi

⁸ <https://www.facebook.com/GADCAbania/posts/pfbid0AeKqovZhjCZhM4CNrdbcOËzqN3LacxuFsbdeheNKM5pYëvETdUfkdJHp9TBqMCl>

dhe Ndryshimet Klimatike”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucion kryesues, për këtë kapitull negociues.

Kapitulli 27 është ndër kapitujt më të rëndësishëm të acquis së BE-së duke përfshirë 73 Direktiva dhe Rregullore, të cilat përbëjnë kuadrin ligjor të BE-së për fushën e Mjedisit dhe Ndryshimeve Klimatike. Kapitulli 27 është një kapitull ndërsektorial ku përfshihen një sërë ministrish linje dhe agjencish të pavarura, të cilat ushtrojnë kompetenca në fushën e mjedisit dhe nënfushat përkatëse të tij. Të gjitha detyrimet raportuese, planifikimin e politikave, strategjitë si dhe monitorimin e zbatimit të tyre e koordinon MTM në cilësinë e institucionit lider për këtë kapitull. Në bazë të metodologjisë së dakordësuar për punën përgatitore deri në takimet bilaterale, në kuadër të procesit të shqyrtimit analitik të acquis, MTM është në proces vlerësimi të kuadrit ligjor të përafuar me legjislacionin e BE-së për kapitullin 27 dhe kapaciteteve institucionale që rrjedhin si detyrim nga implementimi i këtij kuadri.

Bazuar në sa më sipër, do të ishte e rekomandueshme për Bashkinë Pukë që:

- Të ndërmerren masa parandaluese për mbrojtjen e mjedisit;
- Të ketë sanksione ndëshkuese kundrejt individëve që kontribuojnë në ndotjen mjedisore;
- Masat sanksionuese do të shërbejnë si një marrje e përgjegjësisë individuale për dëmtimin mjedisor të kryer.

Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Pukë⁹

Sa i takon infrastrukturës publike dhe planit të shërbimeve, rekomandon:

- Shpërndarje hapsinore të balancuar
- Shmangien e ndërveprimit mes rrjetesh
- Permiresimin dhe modernizimin e strukturave ekzistuese
- Sigurmimin e mbrojtjes së mjedisit

Infrastruktura teknike publike përfshin të gjithë zonën e Bashkisë Pukë, ku objektet ekzistuese synojnë zbatimin e shërbimeve publike në fushat:

- Transport
- Energji
- Menaxhim i ujrave
- Telekomunikacion
- Menaxhim i mbletjeve dhe mbrojtje e mjedisit
- Menaxhim i burimeve natyrore e kulturore
- Mbrojtja kombëtare (urbane dhe zjarrfikëse etj)

⁹ <https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=4170&token=7603b160b50a462d4ba42a648791522e0b98114c> (fq 66- 58)

Sa i përket mbrojtjes civile, duhet të vihen në zbatim:

- Plani i menaxhimit të emergjencave civile ndaj rreziqeve natyrore dhe teknologjike
- Plani lokal i mbrojtjes nga zjarri për bashkinë Pukë

Duke pasur parasysh, rritjen demografike të popullatës për 10 vitet në vijim, si edhe largimet e banorëve nga vendbanimet aktuale, mund të jenë me vend investime si:

- Ndertimi dhe funksionimi i një shkolle të mesme i kulturave bujqësore dhe prodhimit shtazor
- Ndertimi i një universiteti 2 vjecar, aneks i Universitetit Bujqësor të Tiranës (programe: bujqësi, agrobiznes, shkenca pyjore)
- Sistemimi e rrethimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe sportive në shkollat të qendrës dhe njësive administrative
- Ndërtimi i aneksit të stadiumit dhe qendrave sportive

Referenca

Faqja Birn – Reporter: <https://www.reporter.al/>

Faqja zyrtare bashkia Pukë – Plani Social: <https://bashkiapuke.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/PLANI-SOCIAL-BASHKIA-PUKE-FINAL>

Faqja zyrtare bashkia Pukë – Vlerësimi I Territorit: https://bashkiapuke.gov.al/www-content/uploads/2017/09/ANALIZA_DHE_VLER%C3%8BSIMI_I_TERRITORIT.pdf

Fushata advokuese – Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim:

<https://www.facebook.com/GADCAbania/posts/pfbid0AeKqoyZhjCZhM4CNrdbcQWzqN3LacxuFsbdeheNKM5pYwwyETdUftkfDJHp9TBqMCl>

Ligji 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore: https://www.ERRU.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf

Planifikimi i Përgjithshëm vendor i bashkisë Pukë:

<https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=4170&token=7603b160b50a462d4ba42a648791522e0b98114c>

Porta vendore - Mbrojtja e Mjedisit Bashkia Pukë:

<https://portavendore.al/cbenbashkia/mbrojtja-e-mjedisit/>